



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:030222

Datë: 06.11.2018

Numri i dokumentit: 00164609

P. nr.782/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.M. nga Gj., për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6/1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshem në Gjakovë, PP.nr.959/17 të datës 07.11.2017, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datën **06.11.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **D.M.**, nga i ati S., e ëma S., e gjinisë A., data e lindjes:... në Gj., ku dhe tani banon në rrugën N.T. nr...., i martuar- atë i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse: Me datën 18.06.2017 rreth orës 07.25 minuta, në rrugën magjistrale Gjakovë-Prizren duke drejtuar automjetin e markës “V..” tipi “G.” me targa regjistrimi me ngjyrë të zezë, pronë e F. D., mbi shpejtësinë e lejuar jashtë vendbanimit, e vepron në kundërshtim me nenin 56 par.3/1 pika 1.4 të Ligjit nr 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugorë, rrezikon trafikun publik jetën e njerëzve e pasurinë, nga pakujdesia, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet nga veprimi apo mosveprimi i tij me mendje lehtësi mendon se nuk do të shkaktohet, ose do ta ndaloj dhe pasoja e shkaktuar, në atë mënyrë që, duke zhvilluar shpejtësinë 120km/h mbi atë të lejuar 80km/h me të arritur në fshatin Silloven duke lëvizur i hapet hauba e automjetit e i bëhet pengës shikimi përpara ashtu që e humb kontrollin, ndaj automjetit e me automjet sillet në rrugë e gjatë sjelljes lëviz dhe nga pas, në pjesën e pasme të automjetit në pjesën ballore e godet automjetin e markës “C.” tipi “J.me targa të regjistrimit ...ngjyrë e bardhë, pronë e A.M. nga P., i cili po lëvizte në drejtim të Gjakovës, e dëmton automjetin e tij, si dhe vet pëson lëndime të lehta trupore, ndërsa pasagjerit të tij A.K. nga Gjakova i shkakton lëndime të lehta trupore, sipas ekspertizës mjeko-ligjore të Dr.N.H.

dt.13.09.2017, ndërsa të dëmtuarit A. M. nga P. rruga "A." nr.... i shkakton dëm material në automjet, pa lëndime trupore.

- me çka ka kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6/1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,49,50,51,73, 378 par.6/1 të KPRK-dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5(pesë)muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale në emër të ekspertizës së komunikacionit të paguaj shumën prej **40.88.-€**, në emër të ekspertizës mjeko ligjore të paguaj shumën prej **20,00 Euro**, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Të dëmtuarit A.M. nga L. R.Sh. me vendbanim në Rr"A." nr... P. dhe A. M. K. nga Gj. rr."S."pn. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.959/17, të datës 07.11.2017, kundër të akuzuarit D.M. nga Gj., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6/1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Ismet Tofaj, në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari D.M., në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaron se e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohem, për të cilën vepër jam penduar pa masë por premtoi para gjykatës se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit, këtë vepër penale e kam kryer nga pakujdesia e jo me dashje, shton se jam i pa punë dhe me gjendje të dobët materiale, jam mbajtës i vetëm i familjes, si dhe për herë të parë paraqitem në Gjykatë për një vepër të kryer penale por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoi gjykatës që me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethanat e lartë cekura.

I dëmtuari A.K. deklaron se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkoi kompensimin e dëmit nga i akuzuari D., por kompensimin e dëmit nëse më takon do ta kërkoi nga kompania e sigurimit.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj deklaron se: nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe provat dhe në faktet që janë bashkangjitur aktakuzës.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari D.M.: Me datën 18.06.2017 rreth orës 07.25 minuta në rrugën magjistrale Gj.-P. , rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 61 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor dhe vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtua automjetin e llojit “...” tipi “G.” me targa të regjistrimit ... me ngjyrë të zezë, pronë e F.D. , mbi shpejtësinë e lejuar jashtë vendbanimit, vepron në kundërshtim me nenin 56 par.3/1 pika 1.4 të Ligjit nr 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugorë, rrezikon trafikun publik jetën e njerëzve e pasurinë, nga pakujdesia, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet nga veprimi apo mosveprimi i tij me mendje lehtësi mendon se nuk do të shkaktohet, ose do ta ndaloj dhe pasoja e shkakuar, në atë mënyrë që, duke zhvilluar shpejtësinë 120km/h mbi atë të lejuar 80km/h me të arritur në fshatin S. duke lëvizur i hapet hauba e automjetit e i bëhet pengës shikimi përpara ashtu që e humb kontrollin, ndaj automjetit e me automjet sillet në rrugë e gjatë sjelljes lëviz dhe nga pas, në pjesën e pasme të automjetit në pjesën ballore e godet automjetin e markës “C.” tipi “J.” me targa të regjistrimit ... ngjyrë e bardhë, pronë e A.M.nga P. i cili po lëvizte në drejtim të Gj. , e dëmton automjetin e tij, si dhe vet pëson lëndime të lehta trupore, ndërsa pasagjerit të tij A. K. nga Gj. i shkakton lëndime të lehta trupore, sipas ekspertizës mjeko-ligjore të Dr.N. H. dt.13.09.2017, ndërsa të dëmtuarit A.M.nga P. rruga “A.” nr.... i shkakton dëm material në automjet, pa lëndime trupore.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën të shpall fajtores dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-ës të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i dy fëmijëve, mbajtës i familjes, gjendjen e tij të dobët ekonomike, është i pa punë, mbajtës i vetëm i familjes, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit, pranimin e fajësisë, sjelljet korrekte në gjykatë, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, mos dënushmërinë e tij të mëparshme, ndërsa si rrethana rënduese Gjykata murr parasysh intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, të dëmtuarit A.K. në këtë aksident komunikacioni i shkakton lëndime trupore, shkallën e përgjegjësisë penale, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata të njëjtit të shqiptojë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) vitë, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor, dhe shpenzimeve të procedurës penale, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
Departamenti i përgjithshëm
P. nr.782/17 më datë 06.11.2018**

**Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese
Diana Sina**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.